Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- **Njoftimi i Fituesit**
 - Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- **Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
 - Pas confirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 - Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- garanci bankare

- garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- **Procedura e ankesës**
 - Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 - Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- **Anulimi i procedurës**
 - Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 - Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës
- Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit
- Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- a. Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- b. Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- c. Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 1 - FURNIZIM VENDOSJE X-RAY TUBE PËR SKANER CT BRIGHTSPEED 16 SLICE PRODHUES GE OSE EKVIVALENT:

Furnizim Vendorsje X-Ray Tube SOLARIX 350 ose ekuivalent për Skaner CT Brightspeed 16 slice me konsum minimal 40 kAs.

Step 80, 100, 120, 140 kV ose ekuivalent;
Maximum Potential Difference 140 kV;
Dimensionet perafersisht 54,32, 72 (Width, Height, Depth);
Materiali/ Lenda Tungsten – Rhenium ose ekuivalent;
Dual focus (small dhe large);
Rryma maksimale e tubit – Small spot ~ 200 mA, Large spot ~ 350 mA;
Rotor speed ~ 140 Hz;
Anode heat capacity 2000 – 3000 kJ;
Heat Dissipation 2.7 kw (220kHU/min);

LOTI 2 - FURNIZIM VENDOSJE MODUL DETEKTORI PËR PAJISJEN SKANER CT LIGHTSPEED 64 SLC PRODHUES GE OSE EKVIVALENT:

Furnizim Vendorsje Modul detektor për Detektor HDAS64 ose ekuivalent për pajisjen Skaner VCT Lightspeed 64 slc.

Modul detektor per Pajisjen, Detektor me numer 20;
FRDM VCT Lightspeed ose ekuivalent;
Kompatibel me detektor HDAS64 SL ose ekuivalent;
Te jete i klasit 2/ ose 3;

Shërbimi i kërkuar:

Pas instalimeve, konfigurimeve, riparimeve apo ndërhyrjeve të tjera të kryera, shoqëria e kontraktuar (OE) duhet të kryejë kalibrimet e nevojshme, verifikimin dhe testimin e parametrave sipas rekomandimeve të prodhuesit, për garantimin e funksionimit normal të pajisjeve.

Gjithashtu, duhet të mbahet një procesverbal (i standartizuar nga AK) apo Raport Servisi, formati i të cilit miratohet dhe unifikohet nga AK, që përshkruan në mënyrë të detajuar dhe të qartë defektin/problemin, pjesët konsumable të zëvendësuara në qoftë se ka, kalibrimet dhe provën e funksionit.

Raporti i Servisit, i cili do përshkruajë në mënyrë të detajuar defektin dhe shërbimet e kryera, duhet të firmoset nga Shefi i Shërbimit ku ndodhet pajisja ose persona të autorizuar prej tij (staf mjekësor përdorues i pajisjes), specialist të Sektorit të Inxhinierisë Klinike dhe tekniku apo inxhinieri i operatorit ekonomik fitues në këtë procedurë.

Detyrat:

Realizimin e furnizim vendosjes së pjesëve përberëse të pajisjeve mjekësore pjesë e kësaj procedure prokurimi, instalimin, konfigurimin kalibrimin dhe testimin për të rikthyer në gjendje të plotë funksionale pajisjet mjekësore VCT Lightspeed 64 slc dhe CT Brightspeed 16 slice ose ekuivalent.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: PAI Polivalent në QSU “Nënë Tereza”.

Garancia:

Garancia për modulin për Detektor HDAS64 për pajisjen Skaner VCT Lightspeed 64 slc ose ekuivalent duhet të jetë 1(një) vit.

Garancia për tubin X-Ray për pajisjen Skaner CT Brightspeed 16 slice ose ekuivalent duhet të jetë me konsum minimal 40 kAs. Në rast të difektit të tubit X-Ray ose ekuivalent përpara arritjes së nr/ konsumit maksimal të goditjeve, operatori/ bashkimi operator ekonomik fitues do të zëvendësojë me një tub të ri.

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

“Furnizim Vendorsje X-Ray Tube për rikthimin në gjendje të plotë funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Brightspeed 16 slice prodhues GE ose ekuivalent, për nevoja emergjente në Urgjencën Covid dhe Furnizim Vendorsje modul detektori për rikthimin në gjendje të plotë funksionale të pajisjes mjekësore Skaner CT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent”, të ndarë në lote:

Loti 1 – “Furnizim Vendorsje X-Ray Tube për Skaner CT Brightspeed 16 slice prodhues GE ose ekuivalent”

Loti 2 – “Furnizim Vendorsje modul detektori për pajisjen Skaner CT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent”

Nr.	Emertimi	Njësia	Sasia
1	Furnizim Vendorsje X-Ray Tube për Skaner CT Brightspeed 16 slice prodhues GE ose ekuivalent	copë	1
2	Furnizim Vendorsje modul detektori për pajisjen Skaner CT Lightspeed 64 slc prodhues GE ose ekuivalent	copë	1

(I NJEJTE PER TE DY LOTET):

Afatet e lëvrim/ Ekzekutimit: 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga lidhja kontratës (për të dy lotet).

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

• KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimeve të pikës 6, të këtij neni ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor (QSUNT) i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

(TE NJEJTA PER TE GJITHA LOTET)

LOTI 1 – “FURNIZIM VENDOSJE X-RAY TUBE PËR SKANER CT BRIGHTSPEED 16 SLICE PRODHUES GE OSE EKVIVALENT”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Shënim*: Operatori Ekonomik i renditur i pari, me njohjen e renditjes nëpërmjet SPE dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM 285/2021 (Rregullat e Prokurimit Publik) e ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nëse operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë certifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose **SSH EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vleresimit të dokumentacionit, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera mesatare e tyre te jete **jo me e vogel se 40 % e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori ekonomik.**

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e parashikuara ne piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratën ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.**
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore,** ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar të lotit/loteve për të cilen ofertohet, konkretisht mbi vlerat e fondit limit ne piken 2.10 / 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20 % do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës të kontratave për lotet që konkurrohet.

- b) Operatori ekonomik duhet të ketë te pakten 1 (nje) inxhinier / (inxhinier biomedical/elektronik/informatik /elektrik ose fusha te ngjashme) në stafin e vet të certifikuar /trajnuar per instalim dhe servis pajisjesh mjekesore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës te vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave.

Shënim: Ky kriter ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik do te konsiderohet i përmbushur me dorezimin/paraqitjen e formularit permbledhes te vetdeklarimit sipas shtojces 8 te DST, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

c) Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (*pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nese nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqese **oferten teknike**, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret perkates, në formë tabele, ku te plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese për produktet.

dh) Ofertuesi duhet të paraqese një autodeklarate ku deklaron se artikujt do të jenë të shoqeruara me manualet e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualet e servisit/shërbimit.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqes autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë original ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

ë) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autodeklarate për pajisjet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat 98/79/EC (in vitro diagnostic medical devices (të përditësuar) ose (EU) IVDR 2017/746 ose EU 2016/425 (kur është e aplikueshme), ose (EU) 2017/745 - MDR, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkelidhur me kopjet e certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqese deklaratën e garancisë për pjesët/artikujt dhe aksesoret shoqerues (nese aplikohet), në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë për çdo defekt të mundshëm teknologjik, sipas afatit të percaktuar në specifikimet teknike.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqese një deklaratë për furnizimet me mallrave/artikujt mjekësore sipas afatit të percaktuar.

gj) Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku te konfirmoj funksionalitetin e artikujve mjekesore.

h) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate paraprake, per garantimin e marrjes se Lejes prane ZMR (Zyres se Mbrojtjes nga Rrezatimi) per ate kategori artikujsh pjese e ketij objekti prokurimi bazuar ne kodet doganore.

i) Ofertuesi duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se mallrat/artikujt mjekesor jane vendosur dhe ambalazhuara sipas standartit te prodhuesit, ku keto mallra / artikuj sipas objektit te prokurimi te jene te reja, te paperdorura.

j) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se mer persiper kthimin ne gjendje te plote pune dhe funksionale te pajisjeve mjekesore pjese e ketij objekti prokurimi.

k) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se ne rast defekte te shkaktuara nga pakujdesia ose per shkak te nderhyrjes nga ana e tyre te mbuloje demet e shkaktuara me pasoja financiare.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2 – “FURNIZIM VENDOSJE MODUL DETEKTORI PËR PAJISJEN SKANER CT LIGHTSPEED 64 SLC PRODHUES GE OSE EKVIVALENT”:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Shënim*: Operatori Ekonomik i renditur i pari, me njohjen e renditjes nëpërmjet SPE dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM 285/2021 (Rregullat e Prokurimit Publik) e ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, dhe nese operatori ekonomik ofertues është prodhues i pajisjeve mjekësore duhet të paraqesë çertifikatën **SSH EN ISO 13485:2016** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” për tregtim të pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori ekonomik ofertues në rastet **kur nuk është prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet të paraqesë autodeklarate** që furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi është konform standarteve të cilësisë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore” ose **SSH EN ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, të vlefshme, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vleresimit të dokumentacionit, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- b. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera mesatare e tyre të jete **jo më e vogël se 40 %**

e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori ekonomik.

Shënim:* Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas lotit/loteve për të cilën ofertohe, konkretisht mbi vlerat e parashikuara ne piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurren operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore,** ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar të lotit/loteve për të cilën ofertohe, konkretisht mbi vlerat e fondit limit ne piken 2.10 / 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, 20 % do te aplikohet mbi shumën totale të vlerës të kontratave për lotet që konkurrohet.

b) Operatori ekonomik duhet të ketë te paktën 1 (një) inxhinier / (inxhinier biomedical/elektronik/informatik /elektrik ose fusha të ngjashme) në stafin e vet të certifikuar /trajnuar për instalim dhe servis pajisjesh mjekësore objekt prokurimi, të vërtetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatës/çertifikatave të trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës të vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do te konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

c) Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të

hollësisht për secilin artikull (*pjeset e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike**, për pajisjen objekt prokurimi bashkë me aksesoret perkates, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të pajisjes / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese për produktet.

dh) Ofertuesi duhet të paraqesë një autodeklarate ku deklaron se artikujt do të jenë të shoqëruara me manualin e përdorimit, manualin e vendosjes sipas rekomandimeve të prodhuesit dhe manualin e servisit/shërbimit.

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (*ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin*), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e perkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

ë) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për pajisjet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat 98/79/EC (in vitro diagnostic medical devices (të përditësuar) ose (EU) IVDR 2017/746 ose EU 2016/425 (kur është e aplikueshme), ose (EU) 2017/745 - MDR, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave perkatese CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyera dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pjeset/artikujt dhe aksesoret shoqëruar (nëse aplikohet), në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë për çdo defekt të mundshëm teknologjik, sipas afatit të percaktuar në specifikimet teknike.

g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për furnizimet me mallrave/artikujt mjekësorë sipas afatit të percaktuar.

gj) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të konfirmoj funksionalitetin e artikujve mjekësorë.

h) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate paraprake, per garantimin e marrjes se Lejes prane ZMR (Zyres se Mbrojtjes nga Rrezatimi) per ate kategori artikujsh pjese e ketij objekti prokurimi bazuar ne kodet doganore.

i) Ofertuesi duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se mallrat/artikujt mjekesor jane vendosur dhe ambalazhuara sipas standartit të prodhuesit, ku keto mallra / artikuj sipas objektit te prokurimi te jene te reja, te paperdorura.

j) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se mer persiper kthimin ne gjendje te plote pune dhe funksionale te pajisjeve mjekesore pjese e ketij objekti prokurimi.

k) Operatori ekonomik duhet te paraqese deklarate, ku deklarone se ne rast defekte te shkaktuara nga pakujdesia ose per shkak te nderhyrjes nga ana e tyre te mbuloje demet e shkaktuara me pasoja financiare.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
